



QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Programit të aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor në rajonin e qytetit të Shkupit për vitin 2025 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 16/24), Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies së mjeteve financiare për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për furnizimin e formave më ekonomike të ngrohjes - kondicionerë inverter me efikasitet të lartë për ngrohje nr. 08–5934/1 të datës 07.06.2023 dhe nr. 08-3117/1 të datës 28.03.2025, Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e qytetarëve të qytetit të Shkupit për forma më ekonomike të ngrohjes - kondicionerë inverter me efikasitet të lartë për ngrohje për vitin 2025

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim stimulimin e banorëve të qytetit të Shkupit (amvisërive) për përdorimin e kondicionerëve inverter me efikasitet të lartë për ngrohje në shtëpitë e tyre, të cilat janë më ekonomike, më efikas nga ana energjetike dhe të pranueshme nga aspekti ekologjik, banorëve që kanë blerë kondicionerë inverter me efikasitet të lartë gjatë vitit 2025 do t'u kompensojë shpenzimet e bëra gjatë blerjes së pajisjes më së shumti deri në 20.000,00 denarë në vlerë neto për amvisëri. Tatimi mbi të ardhurat personale do të jetë në barrë të Qytetit të Shkupit.

1.2. Thirrja publike do të zgjasë deri në shterimin e mjeteve financiare të parashikuara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2025 për këtë qëllim, ose deri më 01 Tetor të vitit 2025, në varësi të asaj se cili kusht do të paraqitet i pari.

1.3. Nëse shterohen të gjitha mjeteve financiare të parashikuara me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, Qyteti i Shkupit do ta informojë opinionin në ueb-faqen e tij se Thirrja publike është ndërprerë para skadimit të periudhës për të cilin është shpallur.

1.4. Thirrja publike do të realizohet sipas radhitjes së aplikimit, përkatësisht sipas datës dhe kohës së aplikimit dhe pas dërgimit të vërtetimit për stufën e dorëzuar.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrje publike:

2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj) të cilët kanë blerë kondicionerë inverter me efikasitet të lartë për ngrohjen e shtëpisë së tyre (objekt banesor) në periudhën nga 01.01.2025 deri në përfundimin e Thirrjes publike dhe që do të depozitojnë aplikim për kompensimin e shpenzimeve.

2.2 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë dy ose më shumë amvisëri që jetojnë në të njëjtën adresë sipas kartës së identitetit, vetëm me dëshmi të bashkangjitur se bëhet fjalë për familje të ndara (fatura për matës të ndryshëm të energjisë elektrike ose me certifikatë të ndryshme pronësie).

3. Kushtet të cilat duhet t'i plotësojë aplikanti:

3.1 . Aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë në vendbanim në territorin e qytetit të Shkupit (komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj),
- amvisëria të mos ketë shfrytëzuar subvencione për ngrohje (stufë me peleti/ inverter) në amvisërinë e tyre (objekt banesor) nga Qyteti i Shkupit,
- të jetë përdorues i stufës me qymyr, dru, naftë ose mazut,

- ta dorëzojë stufën ekzistuese me qymyr, dru, naftë ose mazut pranë Qytetit të Shkupit ose shërbimeve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit, vetëm pas marrjes së njoftimit për vendin dhe kohën e dorëzimit të stufës, në mënyrë elektronike nga Komisioni. Është përgjegjësi e aplikantit të dorëzojë stufën/at për të cilat ka dorëzuar në aplikim fotografi të stufës/ve të përdorura më parë, në të kundërt nuk do të miratohet subvencioni për shkak të mosplotësimit të kushteve të kërkuara.

-pajisja/et të jetë blerë në vitin 2025, në periudhën nga data 01.01.2025, deri në përfundimin e Thirrjes Publike dhe e njëjta të instalohet në adresën e vendbanimit të shënuar në kartën e identitetit të aplikantit;

- pajisja/et e blerë duhet të ketë detyrimisht të paktën karakteristikat e mëposhtme: të ketë të paktën COP 3.5, të ngrohë në temperaturë të jashtme nga -15 ° C dhe të jetë/në më së paku e klasës energjetike A + për shpenzimin e energjisë elektrike për ngrohje.

- objekti i banimit të mos jetë në fazën e ndërtimit dhe aplikanti të banojë në të,

3.2 Vetëm një person për amvisëri mund të depozitojë aplikim për marrjen e kompensimit, ku aplikimi mund të përfshijë një ose më shumë pajisje, por aplikanti duhet t'i plotësojë kushtet e kësaj thirrjeje publike për të gjitha pajisjet, të dorëzojë aq stufa, sa ka blerë edhe pajisje dhe kompensimi i shpenzimeve të bëra gjatë blerjes së të gjitha pajisjeve të mos tejkalojë shumën prej 20.000,00 denarë në vlerë neto.

3.3 Më shumë amvisëri të cilat janë regjistruar në të njëjtën adresë duhet të paraqesin fatura nga matës të ndryshëm të energjisë elektrike ose një certifikatë pronësie si dëshmi se janë familje të veçanta, të ndara.

3.4. Aplikantët që banojnë në ndërtesa banimi në zonat ku ka ngrohje qendrore të qytetit duhet të marrin dhe të dorëzojnë një vërtetim që nuk janë të lidhur dhe nuk kanë mundësi teknike për t'u lidhur me të.

Vërejtje: Aplikanti duhet të plotësojë të gjitha kushtet e mësipërme që aplikimi i tij të miratohet. Në të kundërt, Komisioni depoziton propozim pranë kryetares së Qytetit të Shkupit për mosmiratimin e kërkesës.

4. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

4.1 Për kompensimin e shpenzimeve dhe konfirmimin se kriteret për pjesëmarrje janë përmbushur, aplikanti pranë Qytetit të Shkupit duhet të depozitojë:

- Aplikimi për kompensim (Aplikimi mund të merret në Arkivin e Qytetit të Shkupit ose të shkarkohet nga faqja e internetit e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- fotografi e ngrohëses/ve me dru, qymyr, naftë ose mazut që përdor dhe që të njëjtën/at duhet ta dorëzojë pas marrjes së njoftimit elektronik nga Komisioni; Është përgjegjësi e aplikantit të dorëzojë stufën/at për të cilat ka dorëzuar fotografi të stufës/ve të përdorura më parë bashkëngjitur me kërkesën, në të kundërt subvencioni nuk do të miratohet për shkak të mosplotësimit të kushtit të kërkuar.
- deklaratë e noterizuar se vullnetarisht do ta/i dorëzojë stufën/at ekzistuese (të fotografuar/a paraprakisht) me dru, qymyr, naftë ose mazut Qytetit të Shkupit ose shërbimeve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit dhe se ai nuk ka shfrytëzuar subvencione për ngrohje (ngrohëse me peleta / inverter) në amvisërinë e vet (objekt banesor) nga Qyteti i Shkupit, si dhe pëlqim se të dhënat e tij personale do të përdoren vetëm për këtë subvencion (ekzemplar i deklaratës do të publikohet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);
- vërtetim/e origjinal i noterizuar me nënshkrim dhe vulë nga shitësi, se kondicioneri inverter i blerë është me efikasitet të lartë, d.m.th. i plotëson karakteristikat minimale të mëposhtme: posedon më së paku SOR 3.5, ngroh në temperaturë të jashtme nga -15°C dhe i përket më së paku klasës energjetike A+, për shpenzimin e energjisë elektrike për ngrohje (ekzemplari i vërtetimit mund të merret në Arkivin e Qytetit të Shkupit dhe do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);

- dëshmi se blerja është realizuar gjatë vitit 2025, edhe atë me llogarinë fiskale origjinale ose me faturë të bashkëngjitur certifikatë nga një bankë afariste, për realizimin e plotë me fletëpagesë të bashkëngjitur – pagesë e plotë.
 - kopje e llogarisë së transaksionit vetëm personale e aplikantit (e paautorizuar nga një person i tretë).
 - kopje e faturave nga matës të ndryshëm të energjisë elektrike ose certifikata pronësie për familje të veçanta që janë në të njëjtën adresë banimi
 - kopja/e e vërtetimit/ve origjinal/e e noterizuar/a me nënshkrim dhe vulë nga Qyteti i Shkupit ose nga shërbimet e ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit, se stufa/t e vjetër është dorëzuar. Vërtetimi përmban: emrin, mbiemrin dhe adresën e aplikantit, vendin dhe datën e dorëzimit, si dhe numrin e identifikimit të aplikimit dhe dorëzohet në mënyrë plotësuese vetëm pas marrjes së njoftimit elektronik nga Komisioni se të njëjtën mund ta dorëzojë,
 - Aplikantët që banojnë në rajone ku ka ngrohje qendrore të qytetit, duhet të dorëzojnë vërtetim se nuk janë të kyçur në ngrohje qendrore të qytetit dhe nuk kanë mundësi teknike për t'u kyçur në të (vërtetim nga ESM-Furnizimi me ngrohje "Elem Energetika" ose Ngrohtore "Shkup Veri" - në varësi të zonës së banimit).
- 4.2 . Aplikanti duhet të depozitojë aplikimin dhe dokumentacionin të bashkëngjitur në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Komisioni për subvencionimin e qytetarëve për forma më ekonomike të ngrohjes – kondicionerë inverter me efikasitet të lartë për ngrohje për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Komisioni") në Arkivin e Qytetit të Shkupit, në bul. "Ilinden" nr. 82, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në orën 15:00.
- 4.3 . Aplikimet e pranuar me dokumentacion përcjellës në Arkivin e Qytetit të Shkupit do të evidentohen me kohën e saktë të depozitimit (data, ora dhe minuta), me qëllim që të përcaktohet radhitja e shqyrtimit të kërkesave.
- 4.4 . Komisioni rezervon të drejtën të dalë në terren dhe të kontrollojë pajisjen e përdorur - stufë për ngrohje, e cila më vonë do të krahasohet gjatë dorëzimit. Gjithashtu, në rastin e dokumentacionit të parregullt (të palexueshëm), Komisioni rezervon të drejtën të kërkojë plotësimin në mënyrë elektronike, i cili do të duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga dita e njoftimit. Nëse nuk plotësohet brenda afatit të caktuar, dokumentacioni i paraqitur i bashkëngjitur kërkesës do të konsiderohet i paplotë dhe i pakompletuar.

Vërejtje: Aplikanti duhet të depozitojë dokumentacionin e plotë bashkëngjitur me kërkesën në përputhje me pikën 4. Në të kundërt kërkesa do të refuzohet.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1 Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike, i cili do ta realizojë procedurën në katër faza:

- në fazën e parë, Komisioni shqyrton kërkesat e pranuar për të përcaktuar se si do të shqyrtohen kërkesat;
- në fazën e dytë, Komisioni kryen kontrollin e hollësishëm të dokumentacionit të depozituar nga pika 4, për të konstatuar plotësimin e kushteve nga pika 3 e kësaj Thirrjeje publike,
- në fazën e tretë, Komisioni do të njoftojë aplikantin e kualifikuar në mënyrë elektronike për vendin dhe kohën e dorëzimit të stufës/ve, dhe
- në fazën e katërt, Komisioni shqyrton certifikatat për stufat e dorëzuara dhe ia bashkëngjijtë dokumentacionit të depozituar.

5.2 Komisioni rezervon të drejtën e kontrollit në terren tek aplikantët të cilët kanë depozituar dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar, për të konfirmuar se kanë plotësuar kushtet e Thirrjes publike. Aplikanti është i obliguar që t'i mundësojë qasje Komisionit në objektin e banimit dhe ambientin ku është instaluar kondicioneri i blerë inverter me efikasitet të lartë.

5.3. Për aplikimet e depozituara dhe të shqyrtuara nga pika 5, nënpika 5.1 alineja 1, do të mbahet listë me të dhënat vijuese:

- emri, mbiemri dhe adresa,

- data dhe ora e dorëzimit të aplikimit për Thirrjen publike, dhe
- vlera e kompensimit për aplikantin.

5.4. Pagesa e mjeteve të miratuara do të kryhet sipas radhitjes së aplikimeve të depozituara, dhe vërtetimit të kompletuar për dorëzimin e stufës, pas miratimit paraprak të aktvendimeve për miratimin e aplikimeve nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

5.5. Gjatë procedurës, Komisioni rezervon të drejtën të inspektojë objektin e banimit dhe ambientin në të cilin është instaluar stufa për të përcaktuar besueshmërinë e përdorimit të stufës ndotëse, e më pas edhe kondicionerit të instaluar.

Në të njëjtën kohë, pas përfundimit të gjithë procedurës, aplikanti duhet t'i mundësojë Komisionit qasje në amvisëri dhe ambientin ku është instaluar pajisja për 2 vitet e ardhshme edhe pas përfundimit të Thirrjes Publike.

5.6. Kryetari i Qytetit të Shkupit në propozim të Komisionit sjell aktvendim për miratimin e aplikimit për aplikantët, të cilët kanë plotësuar kushtet e kësaj Thirrjeje publike, ndërsa në rast mospranimi të të aplikimit, me propozim të Komisionit, kryetarja e Qytetit të Shkupit lëshon njoftim me shkrim për mosmiratim.

Nr. _____

_____viti _____

SHKUP